

VENDIM
Nr. 37, datë 7.7.2021

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA
ÇALIK HOLDING A.Ş. TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË
BANKËS KOMBËTARE TREGTARE SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të shkronjës “h”, të pikës 1, të nenit 24, dhe nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për zotërimin e 100 për qind të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksionar të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., nga *Çalik Holding A.Ş.*
 2. Ngarkohet Banka Kombëtare Tregtare sh.a. të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e transaksionit të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko